



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.165/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi kryesues, Rrustem Thaçi dhe Zyndi Haziri anëtarë, me pjesëmarjen e zyrtarit të lartë ligjor Kudret Hasani, duke vodusur përkitazi me ankesën e Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, për shkak të vendosjes së posterave në hapësirë publike, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 06.10.2019 në seancën e panelit të mbajtur me datë 04.10.2019, mori këtë:

V E N D I M

Pranohet ankesa e Institutit Demokratik të Kosovës (KDI) me seli në Prishtinë, ndërsa subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, i shqiptohet dënim me gjobë në lartësi prej 3,000.00 (tremijë) euro, për shkak të vendosjes së posterave në hapësirë publike, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë), ditë nga dita e pranimit të këtij vendimi nën kërcënim të përmbarimit.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 01.10.2019, nga Institutit Demokratik i Kosovës (KDI), me të cilën pretendon se me datën 30.09.2019, në Bulevardin Bill Clinton tek rrëth rrotullimi në hyrje të Prishtinës, monitoruesi i tyre ka hasur në poster të kandidates për deputete nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), të vendosur në hapësirë publike. Me këtë rast paraqitësi i ankesës thekson se subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), ka bërë shkelje e dispozitës së Nenit 33 paragrafi 1 pika b) i LZP-së Ligji Nr.03/L-073 Në mbështetje të pretendimeve ankimore ka bashkangjitur një fotografi nga vendi ku ka ndodhur shkelja e pretenduar.

Në përgjigjën në ankesë, nga subjekti politik PDK, theksohet se vendosja e posterave është bërë nga simpatizantët e painformuar me Rregullat zgjedhore, ndërsa kandidatja për deputete Evgjeni Thaçi-Dragusha ka ndërmarr masa permisuese duke i larguar posterat nga vendi ku kanë qenë të vendosura ato.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

Ankesa është e bazuar

Nga fotografitë e ofruara si provë të cilat gjendet në shkresat e lëndës shihet qartë se posterat e kandidates për deputete nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), është vendosur në hapësirë publike, veprime këto që janë në kundërshtim me nenin 33 pika b) të LZP-së ,e cila përcakton “*Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në apo mbi rrugët publike*”

Duke u nisur nga gjendja e konstatuar faktike, paneli konstaton se nga provat e ofruara shihet qartë se nga ana e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), është shkelur nenit 33 pika b) i LZP-së, nr.03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, pasi që posterat e kandidates për deputete Evgjeni Thaçi -Dragusha nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), janë vendosur në hapësira publike.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës, si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh rrrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondevë të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura me fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrrethanat për rastin konkret duke pasur parasysh faktin se subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), ka marrë pjesë më herët në zgjedhje dhe se të njëjtit janë të njoftuar me Rregullat zgjedhore. Po ashtu si rrrethanë, PZAP-i mori edhe faktin që këtij subjekti, ia dha mundësinë për t'u përgjigjur, ashtu që në përgjigjen e pranuar nga ana e tyre, të njëjtit e pranojnë shkeljen e bërë nga simpatizant të tyre ku brenda afatit të caktuar nga PZAP-i, subjekti politik në fjalë ka ndërmarrë veprime dhe ka bërë përmirësimin e shkeljes, i cili veprim ka ndikuar në shqiptimin e gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, sepse sipas nenit 3 par. 1 te Rregullores së PZAP-it Nr. 01/2012, shkeljet e kësaj natyre të Kodit të Mirësjelljes për subjektet politike, mund ti shqiptohet gjobë subjektit politik nga 5,100.00 euro deri në 10,000.00 euro, mirëpo siç u konstatua me lart, veprimet e subjektit politik, për ta përmirësuar shkeljen, ka ndikuar në shqiptimin e gjobës.

Subjekti politik brenda afatit të caktuar ka ndërmarrë veprime për të bërë përmirësimin e shkeljes, i cili veprim ka ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi. Me këtë vendim dhe shqiptim të gjobës paneli vendosi se do të ndikon te subjekti politik që mos të përsëriten veprimet e kësaj natyre në të ardhmen. Paneli në kuptim të nenit 120.1 pika c) dhe nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr. 165/2019 më datën 04.10.2019

Kryesues i Panelit
Fejzullah Rexhepi



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së.